



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA ë ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA” PEJE
REKTORATI	
Nr. / Br. / No. <u>2207</u>	Nr. i faqi / Br. str / No. pg <u>7</u>
Data / Datum / Date: <u>09</u> / <u>11</u> / <u>2020</u> Pejë / Peć	

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
“HAXHI ZEKA”**

Në bazë të nenit 17, par.3 dhe nenit 23, të Statutit të Universitetit, Këshilli Drejtues i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me 03.11.2020, plotësoi, ndryshoja dhe miratoi:

RREGULLOREN PËR TË ARDHURAT PERSONALE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Mjetet për të ardhurat personale shfrytëzohen nga fondi i Buxheti të Kosovës, nga tarifat e shkollimit dhe pagesat tjera të cilat i bëjnë studentët, nga pagesat dhe për shërbime komerciale dhe shërbime tjera dhe donacionet, dhuratat dhe ndihma tjera si dhe nga kontratat me organizma kombëtarë, ndërkombe tar publik dhe privat. Nga këto burime financiare paguhen të ardhurat personale dhe kompensimet tjera për personelin akademik dhe jo akademik në marrëdhëniet të rregullt pune, si dhe puna mbi normë dhe puna me honorar për personelin akademik të Universitetit “Haxhi Zeka” (në tekstin e mëtejmë: Universitetit).

Lartësia e të ardhurave personale caktohen në bazë koeficienteve dhe thirrjeve të koduara në shërbimin qendror për të ardhurat sipas kodimit unik për tërë arsimin në Republikën e Kosovë dhe kjo rregullore është resultat i zbatimit të standardeve të njëjtë sipas dispozitave ligjore ne fuqi

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Neni 2

Shërbimi për financa i Universitetit e bënë përllogaritjen e të ardhurave personale dhe pagesave tjera në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit për angazhimin e personelit akademik për çdo vit akademik, përkatesisht raporteve të dorëzuara deri më datën 5 të muajit vijues.

Mbi këtë bazë menaxheri, përkatesisht personi i autorizuar jep urdhër për realizimin e pagesave sipas kontratave të cilat lidhen me të punësuarit me rastin e angazhimit.

Neni 3

Me personelin akademik dhe jo akademik të Universitetit në marrëdhëniet të rregullt pune, në pajtim me dispozitat ligjore lidhet kontratë pune:

Me normë të plotë, dhe

Me gjysmënormë, përkatesisht edhe kontratë mbi veprën.

Universitet mund të lidhë kontratë pune me honorar me personelin akademik më së shumti për një vit akademik, në rastet kur konkursi i publikuar për këto vende nuk realizohet me sukses, apo për shkak të ndonjë rrethane tjetër te pa parashikuar

Marrëdhënien e punës për staf akademikë rregullohet në bazë të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutit të UHZ-së dhe Ligjit të Punës.

III. SANKSIONET

Neni 4

Personeli akademik i cili mungon nga procesi mësimor do të sanksionohet me heqje të pjeshtme të pagës (për profesorë- 1 orë mësimi =50 €, për asistentë, 1 orë =25 €).

IV. PERSONELI AKADEMIK

Neni 5

Për personelin akademik të punësuar në Universitetet përcaktohet norma javore e orëve dhe lartësia e pagës sipas tituve akademik si në vijim:

1. Personeli akademik me normë të plotë të punës

a) Titulli

Nr.	a. Titulli	Orë/javë	Euro
1	Profesorët e rregullt	6 orë/javë	1429.54
2	Profesorët e asocuar	6 orë/javë	1283.34
3	Profesorët asistent	6 orë/javë	1137.14
5	Lektorët	10 orë/javë	844.73
6	Asistentët	10 orë/javë	772.50

b) Për personelin akademik të punësuar në Fakultetin e Arteve të Universitetit "Haxhi Zeka", norma javore e orëve do të jetë si në vijim:

Mësimdhënësit (1-3) 10 orë/javë
Asistentët 16 orë/javë

c) Asistentit, lektorit, me gradë shkencore Dr. i shtohet edhe një pagesë në lartësi prej 50 € mbi pagën bazë të përcaktuar si në pikën 1.

2. Paga sipas posteve udhëheqëse

a) Posti – funksioni

Nr.	Posti funksioni	Paga €	Shtesa €
1	Rektori	Paga bazë	750.00
2	Kryetari i Këshillit Drejtues/MASHT	00.00	250.00
3	Prorektori	Në bazë të thirrjes akademike	550.00
4	Zv. Kryetari i Këshillit Drejtues/MASHT	00.00	200.00
5	Anëtarë i Këshillit Drejtues/MASHT	00.00	200.00
6	Anëtarë i Këshillit Drejtues të zgjedhur nga universiteti	Në bazë të thirrjes akademike	200.00
7	Anëtarët e Senatit	Në bazë të thirrjes akademike	70.00
8	Dekani	Në bazë të thirrjes akademike	350.00
9	Prodekani	Në bazë të thirrjes akademike	250.00
10	Shefi i Departamenti – Degës	Në bazë të thirrjes akademike	70.00

- b) Mësimdhënësi i cili emërohet – zgjidhet në ndonjëren nga postet/funkzionet përveç pagës e cila i takon në bazë të kontratës dhe thirrjes i paguhet edhe shtesa funksionale.
- c) Nëse Kryetari ose anëtarë i Këshillit Drejtues nuk është mësimdhënës në Universitet, i paguhet vetëm shtesa funksionale varësish nga detyra që kryen.
- d) Kryetari, Zv. Kryetari i Këshillit Drejtues, dhe antarët tjerë të Këshillit Drejtues përveç shtesave funksionale mujore do të paguhen edhe për pjesëmarrje në mbledhje në shumë prej 30 euro për Kryetarin e KD-së dhe 25 euro për anëtarët e KD-së.
- e) Rektori dhe Prorektorët i marrin pagat sipas thirrjes akademike dhe shtesat funksionale.

3. Kompensimi për orët e mbajtura mbi normë dhe honorarë

Për profesorët e Universitetit (Prof. i rregullt, Prof. asc. dhe Prof. Ass.) pagesa eshte...30 euro / orë
 Për lektor, asistent, 15 euro / orë
 Rektorit, prorektorit, anëtarët e Këshillit Drejtues të zgjedhur nga UHZ dhe dekanit, në qoftë se mbajnë mësim, iu takon kompensimi deri në 6 orë.

Prodekani ka për obligim të mbajë 3 orë të normës së paraparë sipas thirrjes që mbanë ndërsa 6 orë i paguhen në kuadër të mbinormës.

Kompensimi për mësim jepet për nëntë muaj gjatë viti shkollor

4. Norma e orëve mbi normë dhe honorar

1. Personeli akademik i Universitetit (Prof. i rregullt. Prof i asoc. dhe Prof.ass. ,) që janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet mund të mbajnë deri në 6 orë në javë.
2. Personeli akademik që ka dy marrëdhënie pune, brenda apo jashtë Universitetit Publik "Haxhi Zeka" (primare apo sekondare) nuk mund të marrë orë mbi normë.
3. Për personelin akademik nga pika 5.1. në mungesë të normës së plotë në studimet bachelor norma mësimore duhet të plotësohet edhe me orët nga studimet master dhe atë 1 orë ligjérata në studime master që do të jetë e barabartë me 1 orë ligjérata në studimet bachelor, plotësimi i normës bëhet edhe me orë të cilat do t'i mbajë në njësitë tjera akademike brenda UHZ – së.
4. Lektori, asistenti që janë në marrëdhënie të rregullt pune në universitet mund të mbajnë deri në 8 orë në javë, përjashtimisht, në Fakultetin e Arteve, deri në 5 orë javë.
5. Për personelin akademik njësia akademike është e obliguar që t'i sigurojë orë mësimore deri në normën e plotë. Në rastin kur mësimdhënësit i ofrohen orë për plotësimin e normës dhe ai nuk e pranon, pagesa i bëhet proporcionalisht me numrin e orëve të cilat i mbanë.
6. Orët mbi normë nuk mund t'i jepen personelit akademik i cili e ka normën e plotë, përderisa nuk i plotësohet norma e mësimdhënësve, përkatësisht asistentëve në marrëdhënie të plotë pune nga lëmi i njëjtë.
 - i. Në rast kur mësimdhënësit nuk i plotësohet norma për secilin semestër, ai normën e plotëson me orët e mbajtura mbi normë nga semestri tjetër.
 - ii. Përjashtimisht, nëse mësimdhënësit nuk mund t'i plotësohet norma e plotë e orëve të ligjératave, atë mund ta plotësojë edhe me orë të ushtrimeve në përpjesëtim 1 me 1 por jo më shumë se 2 orë ushtrime nga tërësia e normës.
 - iii. Përjashtimisht nga pika 2.2, mësimdhënësit me një arsyetim të veçantë me shkrim nga dekani i fakultetit, rektori mund të merr vendim për pagesë të orëve të ushtrimeve në proporcione 2 : 1.
7. Personeli akademik jashtë territorit të Republikës së Kosovës mund të angazhohet në procesin e mësimit vetëm me propozimin e Dekanit te aprovuar ne Këshill dhe me



Aprovimin e Rektorit dhe i njëjti do të paguhet 30.00 € për një orë por jo më shumë se 5 orë në javë.

- Në këtë shumë prej 30 € përfshihen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, fjetjes dhe të ushqimit.
8. Asistentëve nuk mund t'iu kompensohen orët e ligjératave. Në raste të veçanta me kërkesë të Këshillit të Fakultetit dhe dekanit të njësisë akademike kur konstatohet se nuk ka mundësi të angazhimit të personelit adekuat, asistenti që ka të regjistruar doktoraturën mund të angazhohet për mbajten e ligjératave.
 9. Pagesa për kategorinë si në pikën 5.8. do të bëhet në bazë të thirrjes akademike.
 10. Personeli akademik që nuk ka marrëdhënie të rregullt pune në UHZ por që angazhohet nga jashtë universiteti, mund të mbajë deri në 6 orë ligjérata në javë me kompensim deri 30 euro ndërsa asistenti deri në 8 orë ushtrime në javë me kompensim 20 euro, me përashtim të Fakulteteve të Arteve deri në 10 orë në javë me pagesë të ushtrimeve.
 11. Angazhimi i personelit akademik me orë mbi normë dhe me honorar në Universitet bëhet në bazë të vendimit të Senatit të Universitetit në propozim të njësisë akademike, më së voni deri me 30 shtator të vitit vijues.
 12. Rektori i Universitetit me propozimin e Dekanit të njësisë akademike, në raste të veçanta ka mundësi që me vendim të veçantë të rrisë angazhimin e personelit akademik nga jashtë ose brenda Universitetit por jo më shumë se se deri 8 orë total mbinorme(6 ore mbi norme plus 2 ore per raste te veqanta sipas kesaj dispozite).

V. KRITERET THEMELORE PËR FORMIMIN E GRUPEVE PËR PUNË MËSIMORE

Neni 6

1. Përcaktimi i grupeve në bazë të numrit të studentëve sipas specifikave të fakulteteve gjatë kohës se pandemisë COVID- 19:

6. 1 Grupi i parë

Ligjérata

Ushtrime

Fakulteti i Biznesit	Lende Obligative 45 për grup Zgjedhore- Grupi minimalisht 45 studente për Bsc dhe 20 për Master	Oblig. - 35 Zgjedh.>20
Fakulteti Juridik	Lende Obligative 60 për grup Zgjedhore- Grupi minimalisht 40 studentë për Bsc dhe 20 për Master	Oblig. - 45 Zgjedh.>20
Fakulteti MTHM-ë	Moduli Menaxhim në Turizëm dhe Hoteleri, Lëndë Oblig. 45 për grup Moduli Menaxhimi i Mjedisit, lëndë oblig. 30 për grup Zgjedhore-Grupi minimalisht 30 studentë për BSC dhe 20 për Master	Oblig. -35 Zgjedh. > 20 Oblig. -15 Zgjedh.

6. 2 Grupi i dytë

Ligjérata

Ushtrime

Fakulteti i Agrobiznesit	TU,Oblig. -35 Zgjedh. > 10 TPB, Oblig.-25 Zgjedh. >10 AA, Obliga.-25 zgjedh. >10	Teori – 20/ zgj. 10/Lab.Ob. 10/Zgj.10
Fakulteti i Arteve (lëndët e përbashkëta) kolektive Lëndët grupore	Oblig. -30 Zgjedh. > 10 Oblig. -10 Zgjedh. > 10	

VI. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR PROVIM

Neni 7

1. Për çdo afat sipas propozimit të Senatit, Këshilli Drejtues i Universitetit do e shqyrtojë mundësinë financiare që mësimdhënësve t'ua kompensojë mbajtjen e provimit në lartësi prej 60 centë për çdo student.
2. Këshilli Drejtues e ka të rezervuar të drejtën që të mos lejojë pagesën e provimeve në rast se konstaton se nuk ka mjete financiare të mjaftueshme.

VII. LARTËSIA E KOMPENZIMIT PËR PUNIME TË DIPLOMËS

Neni 8 i Rregullores bazike, ndryshohet me tekstin si në vijim:

Neni 8

1. Pagesa për mbrojtje të diplomës në studimet bachelor bëhet si në vijim :
 - a) Mentorit 30 euro
 - b) Anëtarët e komisionit 10 euro
2. Një mësimdhënës përgjatë një viti nuk mund të udhëheqë me tepër se 15 kandidatë për diplomim në nivel bachelor, vetëm nëse ka afate shtesë të provimeve atëherë mundë t'i udhëheqë edhe nga 5 kandidatë tjerë për afat.

VIII. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR UDHËHEQJE TË KANDIDATIT NË STUDIMET MASTER

Neni 9

1. Kompensimi për udhëheqje të kandidatit për studime master bëhet si në vijim
 - a) Mentor 250 Euro
2. Një mësimdhënës për gjatë një viti nuk mund të udhëheqë me tepër se 9 kandidatë për diplomim në nivelin master, vetëm nëse ka afate shtesë të provimeve atëherë mundë t'i udhëheqë edhe nga 3 kandidatë tjerë për afat.
3. Mësimdhënësit i takon kompensimi në lartësi prej 3 € për çdo provim të paraqitur të studentit për studime master nëse janë plotësuar kushte e përcaktuara me këtë rregullore.

IX. LARTËSIA E KOMPENSIOMIT PËR KOMISIONIN PËR VLERËSIM DHE MBROJTJE TË PUNIMIT TË DIPLOMËS PËR STUDIME MASTER

Neni 10

1. Kompensimi i komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të diplomës për studentet master bëhet si në vijim :
 - 1.1. Kryetari i komisionit 90 euro
 - 1.2. Anëtarët e komisionit 80 euro

Neni 11

1. Mësimdhënësit në të dy nivelet bachelor dhe master brenda vitiit kanë të drejtë të jenë nga 45 herë anëtarë të komisioneve për mbrojtjen e temave.
2. Të drejtë kanë edhe bashkëpunëtorët e jashtëm të jenë anëtarë të komisionit dhe mentor për mbrojtjen e temave, ndërsa pagesa bëhet konform rregullores e cila duhet të evidentohet në kontratën e punës

X. MËNYRA E REALIZIMIT, VERIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË PAGESAVE PËR ORËT MBI NORMË DHE PROVIZIONET TJERA

Neni 12

Çdo orë e paraqitur për pagesë duhet të arsyetohet me listat e studentëve të pranishëm , të verifikuara nga personi i autorizuar i fakultetit.

Raportet duhet të paraqiten deri më datë 5 të muajit të ardhshëm.

Raportet për orët e mbajtura më të vjetra se 1 muaj nuk paguhen.

XI. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR STUDIME TË DOKTORATURËS

Neni 13

Një mësimdhënës nuk mund të udhëheq më tepër se dy kandidatë për doktoratë brenda një viti akademik.

1. Kompensimi për mesim ne studimet e doktoratës bëhet si në vijim:

- a) Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e moduleve të përgjithshme
1 orë ligjératë = 30 €, por jo më shumë se 28 orë për semestër.
 - b) Kompensimi për orët e mbajtura për grupin e kurseve profesionale
1 orë ligjératë = 30 €, por jo më shumë se 12 orë për semestër

2. Kompensimi për vlerësim të punimit të doktorates bëhet sipas tarifave:

- a) Komisioni për vlerësim të punimit
Mentori.....1000 €
Kryetari i komisionit.....300 €
Anëtari i komisionit.....250 €

Në rastet kur Komisioni për vlerësimin e punimit përbëhet nga mentori dhe komentori, atëherë pagesa do të bëhet si në vijim:

- Mentori.....600 €
- Komentori.....550 €

3. Kompensimi për mbrojtje publike të punimit te doktorates behete sipas tarifave:

- Kryetari i Komisionit.....250 €
- Anëtari i komisionit (3) nga200 €

4. Për kandidatët mësimdhënës të rregullt në Universitet të cilët mbrojnë punimin e doktoratës në Universitetin "Haxhi Zeka" dhe kanë anëtar të komisionit jashtë Kosovës, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit i heqë Universiteti.

5. Kompensimi përkomisionin recensues do të bëhet si në vijim:

a) Kryetari i komisionit.....	50 €
b) Anëtarët e komisionit recensues.....	30 €

XII. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 14

1. Kjo rregullore hyn në fuqi me datën e miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit.
2. Neni 6, i kësaj rregullore mbetet në fuqi deri në përfundimin e pandemisë COVID-19 .
3. Me hyrjen ne fuqi të kësaj rregullore shfuqizohen dispozitat e Rregullores përtë ardhurat personale Ref.nr. 1944, dt. 05.10.2016.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr. Sc. Ardian Berisha

